



Ref.: 1762/24 Datë: 28/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Nuk akreditohet programi i studimeve i Kolegjit Universum kampusi kryesor:
 - *Psikologji BSc 180 ECTS (A)*
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Universum kampusi kryesor në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Psikologji BSc 180 ECTS (A)</i>	Asllan Vrap Pranvera Çollaku Nazyktere Hasani

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat në Kolegjin Universum kampusi kryesor në Prishtinë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit: *Melita Kovacevic, Kristjan Kask dhe Gaga Gvenetadze*.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit për programin, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për këtë program të studimit; *Psikologji BSc 180 ECTS (A)*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 13.06.2024, të cilën kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Substancialisht tre (3) kurse Pjesërisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Universum kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Universum kampusi kryesor në Prishtinë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.